



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 299, Datë 18.11.2022

MBI

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S Nr. 41, DATË 10.03.2022
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “AGE KUÇ” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “KUÇ” ME KAPACITET
TË INSTALUAR 1930 KW”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.11.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1948/3 prot., datë 16.11.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s n. 41, datë 10.03.2022 “Mbi licencimin e shoqërisë “AGE KUÇ” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “KUÇ” me kapacitet të instaluar 1930 kW”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 41, datë 10.03.2022 ka vendosur:
 1. Të licencojë shoqërinë “AGE KUÇ” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kuç”, me kapacitet të instaluar 1930 kW, për një afat 30 vjeçar.
 2. Shoqëria “AGE KUÇ” sh.p.k., të depozitojë lejen e shfrytëzimit të burimit ujor me afate të rinovuara, brenda datës 03.10.2022.
 3. Shoqëria “AGE KUÇ” sh.p.k. të depozitojë në ERE VNM-në Paraprake të lëshuar nga Agjensia Kombëtare e Mjedisit, brenda datës 19.04.2022.
 4. ERE ka të drejtë të rishikojë këtë vendim në çdo kohë, në përputhje me plotësimin/mosplotësimin e kushteve të cituara më sipër, e po ashtu në rast mosplotësimi të kushteve të licencës.

- ERE njoftoi shoqërinë për këtë vendimmarrje me shkresën nr. 49/8 prot., datë 18.03.2022, dhe më tej në respektim të plotësimin të afatit të këtyre kushteve ERE me shkresën nr. 49/9 prot., datë 12.04.2022, i ka sjellë në vëmendje shoqërisë të depozitujë VNM-në Paraprake të lëshuar nga Agjensia Kombëtare e Mjedisit (AKM).
- Me depozitim në ERE të VNM-së Paraprake të lëshuar nga AKM-ja rezulton se është plotësuar kushti i vendosur në pikën 3 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 41/2022, dhe si i tillë ky kusht duhet të shfuqizohet.
- Në kushtet kur shoqëria nuk ka filluar ende operimin, vlerësohet që në kuadër të mbikëqyrjes, t'i kërkohet të depozitujë në ERE informacion mbi fillimin e punimeve për ndërtimin e veprës jo më vonë se 2 (dy) muaj para përfundimit të vlefshmërisë së VNM-së, pra brenda datës 06.04.2024.
- Në komunikimet e mbajtura me shoqërinë “AGE KUÇ” sh.p.k. si dhe në vijim me Agjencinë e Mbrojtjes së Burimeve Ujore (AMBU), rezulton se shoqëria ka aplikuar për rinovimin e lejes së përdorimit të burimit ujor për HEC “Kuç” dhe është në fazë trajtimi. Ndodhur në të tilla rrethana, vlerësojmë që pika 2 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 41/2022 të ndryshojë dhe të bëhet:

2. Shoqëria “AGE KUÇ” sh.p.k., të depozitujë në ERE lejen e shfrytëzimit të burimit ujor të rinovuar, brenda 90 ditëve nga data e aplikimit në Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, për rinovim.
- Në nenin 113 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vet organit, që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pika 2 e dispozitivit të vendimit nr. 41/2022, ndryshon dhe bëhet:

Shoqëria “AGE KUÇ” sh.p.k., të depozitujë në ERE lejen e shfrytëzimit të burimit ujor të rinovuar, brenda 90 ditëve nga data e aplikimit në Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, për rinovim.
2. Të shfuqizojë pikën 3 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 41, datë 10.03.2022 “Mbi licencimin e e shoqërisë “AGE KUÇ” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “KUÇ” me kapacitet të instaluar 1930 kW”.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI